



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 708/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Urtina Ramosaj, kandidate për anëtare të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Urtina Ramosaj, kandidate për anëtare të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga Urtina Ramosaj, kandidate për anëtare të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se ka pas keqpërdorim të votave gjatë numërimit, favorizim i personave tjerë brenda listës tonë, komisioneret e subjektit politik LDK, për Qendrat e Vendvotimeve (QV) si më poshtë: 0101C, 0101X, 0102C, 0106C dhe 0103C.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se *“Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa në përputhje*


me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtror ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 708/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.